



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-12463

Dt. 03.09.2024

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Prokurorisë Themelore Gjakovë – Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës.		
Adresa:	Rruga “Tirana”pn.		
Telefoni:	038 200 66723	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i murit rrethues sipas projektit – dizajnit të prezantuar në lëndë, me lartësi prej 2.5m’, prej së cilës 1m’ me beton dhe 1.5m’ hekur (brenda kufirit kadastral të parcelave me nr. 05069-2 dhe 05068-6, ZK; Gjakovë-Qytet).		
Emri i Projektuesit:	“DEA GROUP”SH.P.K. Prishtinë.		
Adresa:	Rruga “Shaqir Ingrishta” nr. 1		
Telefoni:	044 815 477	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:			
Adresa: “Tirana”.			
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë-J-Qytet	Nr. i parces kadastrale: 05069-2 dhe 05068-6	GPS Koordinatat:	

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input type="checkbox"/>	Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: Lejohet ndërtimi i murit rrethues sipas projektit – dizajnit të prezantuar në lëndë, me lartësi prej 2.5m’, prej së cilës 1m’ me beton dhe 1.5m’ hekur (brenda kufirit kadastral të parcelave me nr. 05069-2 dhe 05068-6, ZK; Gjakovë-Qytet.	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Prokurorisë Themelore Gjakovë – Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës** i lejohej ndërtimi i murit rrethues sipas projektit – dizajnit të prezantuar në lëndë, me lartësi prej 2.5m', prej së cilës 1m' me beton dhe 1.5m' hekur (brenda kufirit kadastral të parcelave me nr. 05069-2 dhe 05068-6, ZK; Gjakovë-Qytet.

VËREJTJE: Ekzekutimi i punimeve duhet të mos e kaloj kufirin kadastral të parcelave me nr. 05069-2 dhe 05068-6, ZK; Gjakovë-Qytet.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
- informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditore të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar sy e t i m

Aplikuesi – **Prokurorisë Themelore Gjakovë – Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës**, e përfaqësuar nga Elida Tabaku, përmes kërkesës me nr. 07-351/02 - 12463 të datës 08.08.2024, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e lejes ndërtimore për ndërtimin e murit rrethues sipas projektit – dizajnit të prezantuar në lëndë në ngastrën kadastrale me numër 05069-2 dhe 05068-6, ZK: Gjakovë-J-Qytet në pronësi të Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës (shfrytëzim afatgjatë për 99 vite).

Zyrtari përgjegjës për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit - skica e matjes së parcelave dhe skica e rregullimit të oborrit nga “DEA GROUP”SH.P.K. Prishtinë.
- Kopjen e planit (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) në pronësi të Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës (shfrytëzim afatgjatë për 99 vite) të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Raport për propozimin vendosjen e dyerve nga ndërmarrja ndërtimore prodhuese Ar-Tech SHPK Suharekë.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga “DEA GROUP”SH.P.K. Prishtinë.
- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit - skica e matjes së parcelave dhe skica e rregullimit të oborrit nga “DEA GROUP”SH.P.K. Prishtinë, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t’i dërgohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë për Punë Inspektuese,**
- **Arkivit.**

Hartoi aktin

Zenel Shabani Z.L. Ligjor

Zyrtari përgjegjës për lëndë

Mirlinda Mullahasani I.D.A.



Drejtori

Arben Bakalli